



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. prot. 689 të datës 20.04.2023, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
2. Marrë parasysh rëndësinë e rregullimit të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës e harmonizimit me standardet ndërkombëtare, me theks të vecantë te organizimi adekuat i zgjedhjeve jashtë kufinjëve të Republikës së Kosovës me qëllim të përfshirjes së mërgatës në proceset e rëndësishme politike brenda vendit, Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë japin mendim pozitiv lidhur me nismën nga par.1 i këtij Vendimi.
3. Ky vendim së bashku me Opinionin ligjor të Zyrës Ligjore - ZKM dhe Opinionin e Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 11 paragrafi 11 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për miratimin e Programit për Zyrën për Çështje të Komuniteteve**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i Programit për Zyrën për Çështje të Komuniteteve (referuar tutje Programi) është mbështetja financiare dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës.

Zyra për Çështje të Komuniteteve (referuar tutje ZÇK), buxhetin e saj e shfrytëzon për:

1. Mbështetje financiare për Mediat, për realizimin e projekteve që kanë për qëllim promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës.
2. Mbështetje financiare për organizatat joqeveritare për realizimin e projekteve që kanë për qëllim aftësimin dhe punësimin e komuniteteve jo-shumicë me theks të veçantë për të rinjtë dhe gratë ose grupet e tjera të marginalizuara brenda komuniteteve jo-shumicë.
3. Mbështetje financiare për aktivitete kulturore që mund të përfshijnë ditë të veçanta ose memoriale, me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve jo-shumicë.
4. Tryeza të rrumbullakëta për komunitetet jo-shumicë me Qeverinë.
5. Mbështetje financiare për personat fizikë për arsye shëndetësore dhe në gjendje të rëndë sociale.
6. Bursat për Studentët e Komuniteteve jo-shumicë (Programi i Ballkanistikës).

## Neni 2

### Fushëveprimi

1. Programi zbatohet nga:
  - 1.1. ZÇK në Zyrën e Kryeministrit dhe të gjithë personat fizikë ose juridikë që janë shfrytëzues të subvencioneve.
2. Buxheti i ndarë për ZÇK për subvencionimin e mediave, personave fizikë dhe OJQ-ve, realizohet në bazë të këtij Programi si dhe përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Buxheti i ndarë për ZÇK për subvencionimin e OJQ-ve, realizohet në bazë të Rregullores së Ministrisë së Financave nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

## Neni 3

### Bashkëpunimi dhe Koordinimi

1. Zyra për Çështje të Komuniteteve gjatë gjithë procesit të zbatimit të Programit për Komunitete do të bashkëpunojë dhe do të koordinohet ngushtë me Zyrën për Qeverisje të Mirë në Kryeministri për t'u siguruar mos diskriminim në ndarjen e fondeve me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies për standardet dhe procedurat për ndarje të fondeve.

## Neni 4

### Parimet

1. Gjatë procesit të ndarjes së subvencioneve duhet respektuar këto parime:
  - 1.1. Liria e pjesëmarrjes në thirrje;
  - 1.2. Jo diskriminimi dhe trajtimi i barabartë;
  - 1.3. Transparenca e procedurave të vendimmarrjes duke i ofruar të gjithë parashtruesve të aplikacioneve të dhënat e nevojshme, duke përfshirë informacion për numër minimum të projekteve ose shuma minimum për secilin nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë;
  - 1.4. Harmonizimi me qëllimet e subvencionimit me efikasitetin e shfrytëzimit të burimeve në bazë të sistemit të konkurrimit dhe kriterëve, të cilat mundësojnë vlerësimin e kërkesave ose projekt propozimeve dhe specifikacioneve teknike për përzgjedhjen dhe ndarjen e subvencioneve;
  - 1.5. Paanshmëria e shqyrtimit të vendimeve dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
  - 1.6. Përrjashtimi i mbivendosjes, që nënkupton ndalimin e financimit të të njëjtit shfrytëzues më shumë se një herë gjatë një viti;
  - 1.7. Ndalimi i subvencionimit të njëjtit projekt nga organizatat e tjera buxhetore ose nga donatorët tjerë, përveç në rastet e bashkëfinancimit.

## Neni 5

### Fondet për mbështetjen e mediave

1. ZÇK shpall thirrje publike me qëllim të ofrimit të mbështetjes financiare të mediave me bazë në komunitete jo-shumicë në Republikën e Kosovës.
2. Thirrja publike shpallet një (1) herë në vit në Ueb faqe të Zyrës së Kryeministrit në mediat elektronike dhe të drejtë aplikimi kanë të gjitha mediat, të cilat i plotësojnë kushtet për aplikim të cilat i përcakton ZÇK-ja, në përputhje me këtë Program, si dhe Rregulloren MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Mediat formularët e plotësuar i dorëzojnë ZÇK-së, në një zarf të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit original të kërkuar, si dhe një kopje elektronike në CD. Formulari plotësohet në një nga gjuhët zyrtare në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e publikimit të konkursit publik.

## Neni 6

### Kriteret e aplikimit

1. Mediat të cilat aplikojnë për mbështetje financiare sipas thirrjes publike të publikuar nga ZÇK, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
  - 1.1. Formulari i projekt - propozimit që shkarkohet nga ueb faqja e Zyrës së Kryeministrit;
  - 1.2. Formulari i propozim buxhetit;
  - 1.3. Mediat duhet që ta kenë bazë në të paktën njërin nga komunitetet jo shumicë në Kosovë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - 1.4. Certifikata e regjistrimit të mediave në organin kompetent të Republikës së Kosovës;
  - 1.5. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e shërbimeve mediatike audiovizuele, e lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Kosovës;
  - 1.6. Certifikata e numrit fiskal;
  - 1.7. Letërnjoftimi i vlefshëm i udhëheqësit të medias ose personit të autorizuar, i lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Kosovës;
  - 1.8. Raporti i fundit gjashtë (6) mujor i llogarisë bankare të medias, dhe;
  - 1.9. Dokumente ose prova të burimeve të financimit/mbështetjes nga donatorët e tjerë, me kërkesë të ZÇK-së.
2. Për produksionet e pavarura dhe mediat e shkruara, pika 1.5 e këtij neni nuk aplikohet.
3. Përveç kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, në thirrjen publike të shpallur nga ZÇK- kërkohej edhe kriteret e përcaktuara me Rregulloren MF Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, po edhe kriteret e tjera të përcaktuara nga ZÇK-ja.

## Neni 7

### Komisioni vlerësues

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, me propozimin të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, e themelon Komisionin vlerësues prej pesë (5) anëtarëve për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të mediave të komuniteteve, prej të cilëve dy duhet të jenë përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, të cilët do të zgjidhen përmes një thirrje publike.
  - 1.1. Ekspertët mund të dërgojnë CV-të e tyre përmes postës apo edhe e-mailit.

2. Për përbërjen dhe mandatin e Komisionit vlerësues aplikohen dispozitat e Rregullores MF Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

## Neni 8

### Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues dhe vendimmarrja

1. Komisioni është i obliguar që detyrat dhe përgjegjësitë si dhe vendimmarrjen ta bëjë në përputhje me Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe t'i zbatojë të gjitha procedurat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të parashtruara nga mediat dhe të bëjë përzgjedhjen e mediave përfituese të cilat i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Program dhe me Rregulloren MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Komisioni, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, i kryen të gjitha procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së mediave përfituese.
3. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes, Komisioni në afatin prej tre (3) ditësh e informon ZÇK-në për listën e mediave përfituese.

## Neni 9

### Kriteret për përzgjedhjen e mediave përfituese

1. Me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së mediave përfituese, Komisioni duhet t'i marrë parasysh këto kriteret:
  - 1.1. Përvoja dhe kapacitetet e mediave në zbatimin e projekteve paraprake;
  - 1.2. Që media ka bazë në të paktën njëra nga komunitetet jo-shumicë në Republikën e Kosovës;
  - 1.3. Prioritet për projekte që merren me grupet e marginalizuara edhe brenda komuniteteve jo-shumicë;
  - 1.4. Pritjet dhe shpenzimet; si dhe
  - 1.5. Përshtatshmërisht aplikohen edhe kriteret e përcaktuara me Rregulloren MF Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

## Neni 10

### Shpallja e mediave përfituese dhe procedura e ndarjes së mjeteve

Shpallja e mediave përfituese dhe procedura e ndarjes së mjeteve si dhe monitorimi i zbatimit dhe raportimi bëhet në përputhje me Rregulloren MF Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

## Neni 11

### Financimi i OJQ-ve

1. ZÇK shpall konkurs për aplikim me qëllim të ofrimit të mbështetjes financiare për OJQ.
2. Çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me thirrje publike e cila do të publikohet në ueb faqen e ZÇK-së.
3. Thirrja do të jetë e hapur së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.
4. Gjatë kohës kur është e hapur thirrja, OJQ-të e interesuara mund të kërkojnë sqarime përmes postës elektronike dhe informacione shtesë përkritazi me thirrjen, por jo më vonë se 5 ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.

## Neni 12

### Kushtet e aplikimit

1. Thirrja publike duhet të përmbaj informacionet në vijim:
  - 1.1. Udhëzimet e thirrjes për aplikuesit, duke përfshirë kriteret për përzgjedhjen e përfituesve;
  - 1.2. Formularin për përshkrimin e projektit;
  - 1.3. Formularin e buxhetit;
  - 1.4. Listën e plotë të dokumenteve të nevojshme për t'u paraqitur në thirrje;
  - 1.5. Datën e hapjes dhe mbylljes së thirrjes;
  - 1.6. Të dhënat për dorëzimin e aplikacioneve;
  - 1.7. Të dhënat për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes dhe kontraktimit;
  - 1.8. Dhe kriteret shtesë të kërkuara nga ZÇK.

## Neni 13

### Kriteret e përgjithshme

1. Për tu kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale si në vijim:
  - 1.1. Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirin e asocimit në organizata jo-qeveritare;
  - 1.2. Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
  - 1.3. Të kenë kryer gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
  - 1.4. Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete përveç në rast bashkëfinancimi;
  - 1.5. Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/ udhëheqësit të aplikuesit të organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikës e Kosovës.
2. Me qëllim të dëshimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni aplikuesi dorëzon certifikatën përkatëse, dhe për paragrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5 aplikuesi nënshkruan dhe dorëzon deklaratat përkatëse.
3. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikuesi nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.

4. Kriteret të tjera të përgjithshme dhe specifike janë të bazuara në Rregulloren e Ministrisë së Financave MF Nr. 04-2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, por edhe kritere shtesë nga ofruesi i mbështetjes financiare.

#### Neni 14

##### Komisioni i Vlerësimit

1. Themelohet Komisioni Vlerësues me mandat për shqyrtimin e aplikacioneve. Përbërja e komisionit, kohëzgjatja dhe mandati caktohet me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.
2. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtar, si në vijim:
  - 2.1. Një përfaqësues nga njësia përkatëse, në kuadër të cilës është planifikuar mbështetja financiare;
  - 2.2. Dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, të cilët do të zgjidhen përmes një thirrje publike të cilën do e bëjë ZÇK-ja;
  - 2.3. Dy përfaqësues nga ZKM/ZÇK njëri prej të cilëve do të jetë nga njësia për buxhet dhe financa.
3. Përveç këtyre anëtareve, do të jetë edhe një anëtar rezervë i cili do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi.
4. Anëtarët e Komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik.
5. Komisioni formohet në bazë të Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe merr përsipër të gjitha obligimet dhe përgjegjësit të cilat dalin nga kjo Rregullore.

#### Neni 15

##### Kriteret për aplikim të personave fizik

1. Të gjithë personat fizikë që aplikojnë për përfitimin e subvencioneve në ZÇK duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:
  - 1.1. Formularin e aplikimit, i cili mund të shkarkohet nga faqja e internetit të Zyrës së Kryeministrit;
  - 1.2. Arsyetimi i kërkesës për përfitimin e subvencioneve, përfshirë qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e zbatimit, rezultatet e synuara dhe ndikimin e tyre. Të dhënat personale që do të grumbullohen janë emri, mbiemri, përkatësinë etnike, adresën dhe kontaktet. Informatë që do të publikohen për përfitues të përzgjedhur janë vetëm inicialet e emrit/ mbiemrit, përkatësinë etnike, komuna dhe shuma e ndarë;
  - 1.3. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe prej një nga komunitetet jo shumicë në Republikën e Kosovës;
  - 1.4. Dokumentin e vlefshëm të identifikimit të Republikës së Kosovës;
  - 1.5. Kopje të llogarisë bankare të njëres prej bankave në Kosovë;
  - 1.6. Dokumente të tjera mbështetëse që vërtetojnë nevoja të tjera për përfitimin e subvencionit, si dhe;
  - 1.7. Kriteret tjera të kërkuara nga ZÇK-ja;
  - 1.8. Personat fizik që mund të përfitojnë subvencione janë personat në gjendje të rëndë ekonomike dhe arsye shëndetësore, përjashtimisht edhe ndonjë rast urgjent;

- 1.9. Për shkak të kërkesave të vazhdueshme dhe urgjente thirrja për persona fizik do jetë e hapur gjatë tërë vitit;
- 1.10. Limitet Buxhetore, Zyra për Çështje të Komuniteteve lejon subvencionimin e personave fizik deri në shumën maksimale 2000 €, (dy mijë euro ), shumë kjo e cila ka kuptimin e vetëm një përfituesi;
- 1.11. Buxheti i ndarë për persona fizik për vitin 2023 mund të shkoj deri në 8% e buxhetit total të ZÇK-së.

## **Neni 16**

### **Themelimi i Komisionit për vlerësim, detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, me propozim të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, themelon Komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të pranuar nga personat fizik.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë duke përfshirë kryesuesin.
3. Komisioni shqyrton dhe vlerëson të gjitha aplikacionet e personave fizikë, të cilët bëjnë kërkesë në ZÇK për përfitimin e subvencioneve në bazë të formularit për vlerësimin e aplikacioneve të personave fizik, i cili është pjesë përbërëse e këtij Programi.
4. Komisioni mblidhet dy herë brenda vitit 2023, për të shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e personave fizik.
5. Komisioni për punën e vetë i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

## **MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

### **Neni 17**

#### **Monitorimi i zbatimit të subvencioneve për persona fizik**

1. Monitorimi i zbatimit të projekteve të subvencionuara nga ZÇK-ja kryhet në përputhje me Rregulloren e MF nr. 04/20017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Subvencionet monitorohen nga Ekipi i Monitorimit, i cili themelohet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, ashtu siç përcaktohet në Rregulloren 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Ekipi përbëhet nga tre (3) anëtarë.
4. Personat fizikë përfituesit e subvencionit janë të detyruar të paraqesin në ZÇK një raport narrativ mbi zhvillimin e zbatimit të subvencionit, ndërsa tridhjetë (30) ditë pas realizimit të subvencionit janë të detyruar të paraqesin raportin përfundimtar narrativ, raportet financiare dhe të paraqesin prova (fatura fiskale dhe prova të tjera) që vërtetojnë se subvencioni është realizuar ashtu siç është planifikuar dhe plotësisht në përputhje me këtë Program.



5. Përfituesit, gjatë dorëzimit në ZÇK, raportit narrativ duhet t'i bashkëngjisin edhe dokumentet e mëposhtme:
  - 5.1. Letërnjoftimin e vlefshëm të personit të autorizuar, lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Kosovës;
  - 5.2. Fatura origjinale me numër fiskal;
  - 5.3. Pagesa të bëra përmes njërës prej bankave të licencuara në Republikën e Kosovës;
  - 5.4. Sipas nevojës edhe dokumente të tjera të kërkuara nga ZÇK-ja.
6. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës nga përfituesi, Komisioni informon ZÇK-në, me rekomandim për hapat e mëtejshëm.
7. Në rast të shkeljes së kontratës ose mos paraqitjes së një raporti, ofruesi i ndihmës financiare mund të vendosë që të ndërpresë kontratën, të kërkojë kthimin e fondeve të marra nga personat fizik. Nëse mjetet financiare nuk kthehen brenda afatit të caktuar nga ZÇK-ja, iniciohet procedura gjyqësore.

### **Neni 18**

#### **Kontrata me përfituesin**

1. Në bazë të rekomandimit të Komisionit të Vlerësimit, nënshkruan një kontratë me shkrim me përfituesin e subvencioneve brenda 45 ditëve nga data e mbylljes së thirrjes publike dhe mjetet kalojnë në llogarinë e përfituesit pas rezultateve finale dhe mbylljes së afatit të ankesës.
2. Përmbajtja e kontratës përcaktohet në përputhje me dispozitat e Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

### **Neni 19**

#### **Programi i Ballkanistikës**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, me propozimin e Zyrës për Çështje të Komuniteteve, do të ofrojë pesë (5) bursa të plota për studentët e komunitetit jo shumicë që janë studentët e Ballkanistikës.
2. Universiteti i Prishtinës (UP) pas thirrjes publike për bursa të studentëve do nënshkruajnë marrëveshje me ZÇK-në për ndarjen e mjeteve.
3. Kriteret dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm do theksohen në thirrjen publike nga ana e Universitetit të Prishtinës.
4. Në marrëveshje me UP dhe studentët, përfituesit e këtyre bursave mund të ftohen edhe për punë praktike në ZKM.

## E DREJTA PËR ANKESË

### Neni 20

#### Komisioni i Ankesave

1. Kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues aplikantët mund të ushtrojnë ankesë pranë Komisionit të Ankesave.
2. Për themelimin, përbërjen, mandatin dhe procedurat e punës së Komisionit të Ankesave, zbatohen dispozitat e Rregullores së MF-së Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

### Neni 21

#### Subjektet të cilat nuk mund të marrin subvencione

Personat fizikë, personat juridikë, OJQ-të, media që shkelin detyrimet ligjore apo kanë shkelur këto detyrime gjatë dy viteve të fundit të përcaktuara nga ky Program, si dhe nuk paraqesin raporte narrative dhe financiare, përveç masave të tjera të parashikuara me këtë Program, përfshihen në listën e subjekteve të cilave **u ndalohet** të marrin subvencione nga buxheti i ZÇK-së.

### Neni 22

#### Auditimi

1. Njësia përgjegjëse për Auditimin e Brendshëm në ZKM, në pajtim me legjislacionin në fuqi bënë auditimin e procedurave të subvencionimit të parapara me këtë Program.

### Neni 23

#### Konflikt interesi dhe transparenca

1. Në rast se ekziston një konflikt interesi me një nga anëtarët e Komisionit, në atë rast anëtari i Komisionit zëvendësohet dhe emërohet anëtari tjetër ad-hoc për procedurat e zgjedhjes dhe votimit.
2. Të gjitha rastet e konfliktit të interesit duhet të shmangen, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Procedura e ndarjes së subvencioneve, puna e Komisioneve vlerësuese dhe monitorimi i zbatimit të projekteve do të përcillen nga një proces transparent, i pavarur dhe i paanshëm.

Neni 24

**Ndryshime dhe plotësime të këtij vendimi**


Ky Vendim ndryshohet dhe plotësohet sipas procedurës së njëjtë të miratimit.

Neni 25

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës-Република Косово-Republic of Kosovo  
Qeveria - Влада -Government

Zyra e Kryeministrit / Канцеларија прелијера / Office of Prime Minister

Zyra për Çështje të Komuniteteve/ Канцеларија за питања заједница /Office for Community Affairs

**Forma e vlerësimit të kërkesës/Образец за ocenjivanje zahteva**

*Personi fizik, Fizicko,:*

Aplikacionet do të vlerësohen sipas shkallës prej 100 pikëve, si më poshtë: Zahtevi ëe biti ocenjeni prema skali od 100 bodova, kao što sledi:	Numri maksimal i pikëve Maksimalan broj osvojenih bodova
1. A është sqaruar në mënyrë adekuate kërkesa drejtuar ZÇK? 1. Da li je na odgovarajući način objašnjen zahtev dostavljen KPZ?	20
2. A i adreson kërkesa objektivat dhe rezultatet e pritura në bazë të mandatit të ZÇK? 2. Da li zahtev adresaira objektivnosti i rezultate koji se očekuju u okviru mandata KPZ?	20
3. A janë të përcaktuar qartë përfituesit dhe nevojat e tyre? 3. Da li su jasno definisani korisnici kao i njihove potrebe?	20
4. A është buxheti në përputhje me nevojat e parashtruara në kërkesë? 4. Da li je budžet u skladu sa predloženim potrebama?	20
5. A është prej një komuniteti jo-shumicë 5. Da li pripada nevećinskoj zajednici?	20
Shuma totale e pikëve Ukupan zbir bodova	100

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi/Potpis: \_\_\_\_\_



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Trajtimin Mjekësor dhe Psikologjik, të Fëmijës Viktimë e Abuzimit, për t'i Ndihtuar në Rehabilitim dhe për t'u ri Integruar në Shoqëri.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 13 dhe 128 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni ad-hoc për shqyrtimin e ankesave në procesin e rekrutimit të kandidatëve për Komisionin e Autoritetit të Konkurrencës, si në vijim:
  - 1.1. Agron Gashi, Koordinator i Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit, kryesues;
  - 1.2. Fahrije Qorraj - Kaloshi, Zyrtare e Lartë për Trajnime dhe Barazi Gjinore, Ministria e Ekonomisë, anëtare;
  - 1.3. Shkurte Krasniqi, Udhëheqëse e Divizionit për Rregullim më të Mirë, Sekretariati Koordinues i Qeverisë në Zyrën e Kryeministrit, anëtare.
2. Komisioni obligohet të shqyrtojë të gjitha ankesat e pranuar në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Komisioni do të shqyrtojë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ ankimor vetëm nëse ankesa është e pranueshme.
4. Komisioni vendos mbi çështjen e ankesës dhe njofton palën ankuese për Vendimin e marrë brenda afatit të paraparë ligjor të përcaktuar në Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 34, paragrafi 12. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 17 paragrafi 3. i Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**


1. Emërohet Komisioni i Pranimin për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin: Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike, Grupi Nr.8 në këtë përbërje:
  - 1.1. Shqipe Abdullahu, Zyrtare për Politika të Pagave në DMZP/MPB, kryesuese;
  - 1.2. Lirie Berisha, Drejtore e Departamentit për Azi dhe Oqeani/MPJD, anëtare;
  - 1.3. Vigan Berisha, Udhëheqës i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/MPJD, anëtar;
  - 1.4. Besim Berisha, Udhëheqës i Divizionit për Planifikim dhe Koordinim të Politikave/MPJD, anëtare;
  - 1.5. Arben Hajrullahu, Universiteti i Prishtinës "Fakultetit Filozofik" anëtar.

Zëvendësues të anëtareve të komisionit

- 1.1. Zade Kuqi, Zyrtare e Lartë për Politikën e Përshkrimit dhe Klasifikimit të Vendeve të Punës, DMZP/MPB;
- 1.2. Riza Fazliu, Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit të Arsimit/MASHTI;
- 1.3. Hamdi Reqica, Udhëheqës i Drejtoratit për Publikime Studime dhe Hulumtime/MPJD;
- 1.4. Mirsada Voca, Udhëheqëse e Divizionit të Vizave /MPJD;
- 1.5. Feim Maliqaj, Organizata të specializuara "InnDev LLC".

2. Komisioni i Pranimi për institucionet e administratës shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike, Grupi Nr.8 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi ka një mandat dy (2) vjeçar.
3. Anëtari nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
4. Komisioni i Pranimi për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike, Grupi Nr.8 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtroj në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:


**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"**

1. Pika 1, e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25.02.2022, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
  - 1.1. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, i amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2023/192 (30.01.2023), Nr. 2023/253 (07.02.2023), Nr. 2023/426 (25.02.2023), Nr. 2023/429 (25.02.2023), Nr. 2023/571 (13.03.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP, (17.03.2014), i amendamentuar me vendimet: (CFSP) 2023/193 (30.01.2023), (CFSP) 2023/261 (07.02.2023), (CFSP) 2023/432 (25.02.2023), (CFSP) 2023/572 (13.03.2023);
  - 1.2. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014) lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë lidhur me situatën në Ukrainë, e amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU), Nr. 2023/180 (27.01.2023), Nr. 2023/250 (04.02.2023), Nr. 2023/251 (04.02.2023), Nr.2023/427 (25.02.2023), Nr.2022/428 (15.03.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP (31.07.2014), i amendamentuar me vendimet: (CFSP) 2023/191 (27.01.2023), (CFSP) 2023/252 (04.02.2023), (CFSP) 2023/434 (25.02.2023), (CFSP) 2022/430 (15.03.2022);
  - 1.3. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2022/263 në lidhje me masat kufizuese në përgjigje të njohjes së zonave të kontrolluara joqeveritare të rajoneve Donetsk dhe Luhansk të Ukrainës dhe urdhërimin e forcave të armatosura ruse në ato zona, e amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/595 (11.04.2022), Nr. 2022/626 (13.04.2022), Nr. 2022/1903 (06.10.2022), respektivisht Vendimin e Këshillit 2022/266/(CFSP), i amendamentuar me Vendimin (CFSP) 2023/388 (20.02.2023);

- 1.4. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2017/1770 lidhur me masat shtrënguese ndaj situatës në Mali, dhe veprimeve të Grupit Wagner, e amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) 2023/428 (25.02.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit (CFSP) 2017/1775, i amendamentuar me Vendimin (CFSP) 2023/431 (25.02.2023);
- 1.5. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2020/1998, lidhur me masat shtrënguese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut, e amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2023/500 (07.03.2023), Nr. 2023/430 (25.02.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit: (CFSP) 2020/1999, i amendamentuar me Vendimin (CFSP) 2023/501 (07.03.2023), (CFSP) 2023/433 (25.02.2023).
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1, konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, plotësohen apo ndryshohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.05/121 i datës 25 janar 2023 për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, në pikën 1.5.2. ku në vend të Driton Sylqa, i cili ka dhënë dorëheqje, do të jetë: Behrije Ramaj - Desku, dhe në pikën 1.8.1. të tij, në vend të Driton Hapçiu i cili ka dhënë dorëheqje, do të jetë, Ylber Gjocaj.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr.05/121 të datës 25 janar 2023.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/142  
Datë: 10.05.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik" për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK - Sh. A.), Zona Kadastrale Kryshevc, Komuna Obiliq dhe Zona Kadastrale Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ndërmarrja Publike Qendrore-Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-Sh. A. ).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/142  
Datë: 10.05.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të cilat janë të nevojshme për realizimin e "Projekteve Infrastrukturore për Interes Publik", Zonat Kadastrale: Bistricë, Bistricë e Shalës, Dren, Leshak dhe Koshotovë, Komuna Leposaviq dhe Zonat Kadastrale: Bërnjak, Zubin Potok, Bregu i Madh, Banjë dhe Jasenovik i Epërm, Komuna Zubin Potok, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/142

Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Masat e Sigurisë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Mbrojtjes obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 11/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për "Projektin për Promovimin e Sipërmarrjes".
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshje, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Kodin e Komunikimeve Elektronike.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 13/142  
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr.05/L-192, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-237 dhe Ligjin Nr.05/L-068, nenit 6 paragrafi 2.1. në lidhje me nenin 5 paragrafi 1.3. të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. I propozohet për shkarkim Kuvendit të Republikës së Kosovës, anëtarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit, znj. Kimete Gashi për shkeljen e etikës profesionale.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me rastin e vendimmarrjes sipas lëndës PSh Nr.397/22, në kundërshtim me legjislacionin primar, konkretisht Ligjin Nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, tenton të lejojë plasimin në treg të insulinave pa autorizim marketing, duke rrezikuar kështu shëndetin publik. Marrë parasysh që udhëheqësinë e panelit në këtë lëndë kishte znj. Kimete Gashi, Qeveria vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë